



Prishtinë, 10 shtator 2014

Për: Koalicinin Kundër shtrenjtimit të Rrymës

Nga: Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) e Republikës së Kosovës

Lënda: Përgjigje e ZRRE-së ndaj Kërkesës për revokim të vendimit

Të nderuar,

Në lidhje me kërkesën tuaj, Bordi i ZRRE-së ju njofton se të gjitha kundërshtimet e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile rreth shqyrtimit të jashtëzakonshëm janë shqyrtuar me seriozitetin më të madh. Mirëpo përkundër komenteve të paraqitura, legjislacioni në fuqi dhe rregullat e tregut energjetik e kanë pamundësuar Bordin e ZRRE-së të merr Vendime ndryshe nga ato të cilat janë marrë. Bordi i ZRRE-së thekson se bashkëndien me të gjithë qytetarët sa i përket ngritjes së tarifave të energjisë, si edhe ngjarjeve të tjera që i kanë paraprirë këtij vendimi, por duhet të kuptohet se mandati i Bordit të ZRRE-së si dhe obligimet janë të përcaktuara në bazë të ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjeve tjera në fuqi. Në rastin e këtij shqyrtimi të jashtëzakonshëm, Bordi i ZRRE-së sipas rregullave përkatëse të sektorit energjetik ka miratuar vetëm kosto minimale të arsyeshme që t'ju sigurojë konsumatorëve furnizim të mirëfilltë me energji elektrike me gjithë vështirësitë e sektorit energjetik në Kosovë.

Me pranimin e emërimit nga Kuvendi i Kosovës, çdo anëtar i Bordit të ZRRE-së po ashtu ka pranuar edhe të gjitha obligimet ligjore të specifikuara në Ligjin e Rregullatorit për Energji dhe ligjet e tjera, ligje këto të votuara nga Kuvendi i Kosovës. Një prej obligimeve kryesore është që të sigurohet një furnizim i mirëfilltë i të gjithë konsumatorëve të energjisë elektrike me kosto të arsyeshme. Pavarësisht mendimeve dhe dëshirave të anëtarëve të Bordit të ZRRE-së, Vendimet e këtij organi duhet të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi edhe atëherë kur Vendimet mund të hasin në kundërshtime nga palët e interesit. Duhet të theksohet se për shkak të rolit të paraparë të ZRRE-së, në shumë situata, Vendimet e Bordit të ZRRE-së kontestohen ose nga të licencuarit ose nga konsumatorët të cilët duhet të paguajnë për këto shërbime.

Për shkak të rëndësisë që sektori energjetik luan në zhvillimin e një vendi dhe kompleksitetit në marrjen e Vendimeve për të zhvilluar këtë sektor, Bordi i ZRRE-së është fuqizuar të veprojë i pavarur nga ndikimet politike duke përfshirë këtu edhe ndikimet e mundshme nga institucioni më i lartë legjislativ i vendit, përveç në rastet e ndryshimeve të ligjeve në fuqi. Duhet sqaruar se të gjitha Ligjet e sektorit të energjisë duke përfshirë këtu edhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik në Kosovë.



Janë ligjet dhe rregullat ato që precizojnë procedurat për marrjen e vendimeve të Bordit të ZRRE-së si dhe apelimin e këtyre vendimeve në instanca të tjera. Ashtu siç ka sqaruar edhe më herët, ZRRE thekson se me datën 29.08.2014, në mbledhjen publike, Bordi i ZRRE-së ka nxjerrë Vendimet nr. V_644_2014 dhe nr. V_645_2014 të datës 29.08.2014, lidhur me aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për Furnizuesin Publik dhe aprovimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar për vitin relevant tarifar SHTE8 që do të zbatohen nga i licencuari nga data 1 shtator 2014. Pikërisht, për shkak të ndikimit të çmimit të energjisë në çmime tjera të produkteve në Kosovë dhe duke pasur parasysh pavarësinë e Bordit të ZRRE-së në marrjen e Vendimeve në mënyrë profesionale, legjislacioni në fuqi ka specifikuar se Vendimet të cilat kanë ndikim tek qytetarët e vendit duhet të merren përmes një procesi të hapur konsultativ. Siç keni qenë edhe ju të njoftuar për hapjen e procesit konsultativ për shqyrtimin e jashtëzakonshëm, ZRRE ka njoftuar edhe të gjitha palët tjera të interesit duke përfshirë këtu edhe organet shtetërore në lidhje me kërkesat e operatorëve dhe vlerësimet e ZRRE-së. Gjatë procesit të konsultimeve publike dhe vetëm atëherë, sipas legjislacionit në fuqi ZRRE hap mundësinë për të pranuar komente nga institucionet tjera shtetërore që do të mund të kontribuonin nga këndi i përgjegjësive të tyre.

Bazuar në ligjet në fuqi mandati, funksionimi dhe obligimet e ZRRE-së nuk kufizohen nga ngjarjet politike të cilat në këtë rast kanë rezultuar në mungesë të funksionimit të përkohshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye institucioni i vetëm shtetërorë që mund të ndryshojë apo kufizojë Vendimet e Bordit të ZRRE-së është gjykata kompetente e cila po ashtu është e pavarur nga degët e tjera të shtetit, në këtë rast nga dega legjislative e shtetit. Prandaj edhe në fund të Vendimeve për shqyrtim të jashtëzakonshëm të përmendura më lartë, të cilat janë të publikuara në faqen elektronike të ZRRE-së, është specifikuar edhe Këshilla Juridike ku theksohet se: “Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit”.

Bordi i ZRRE-së, ju bënë thirrje të gjithë palëve të interesit dhe organizatave nënshkruese të kësaj kërkesë, të ushtroni të drejtën tuaj dhe të veproni duke ndjekur rrugët ligjore/institucionale të Republikës së Kosovës të parapara me legjislacionin në fuqi nëse konsideroni se është bërë ndonjë shkelje ligjore e kompetencave të ZRRE-së gjatë marrjes së këtij Vendimi. Bordi i ZRRE-së ka analizuar çdo detaj të këtij shqyrtimi duke përfshirë edhe të gjitha pakënaqësitë e shprehura të konsumatorëve dhe ka arritur në përfundim se vendimi për ngritje të tarifave elektrike prej 5.18% është i domosdoshëm për një furnizim të mirëfilltë. E vetmja rrugë për revokim apo ndryshim të Bordit të ZRRE-së, sipas kërkesës së paraqitur është apelimi tek gjykata kompetente.

Me respekt,

Bordi i ZRRE-së